

vunë zjarrin edhe shtëpisë së Zekës. Atë e vranë në oborr. Trupin e tij e kanë gjetur banorët që u kthyen të parë në fshat pas tërheqjes së forcave serbe. Trupi i tij ishte i masakruar me thikë. Më 25.05.1998, djali i xhaxhait të Zekës, Xhevati, me ndihëm e bashkëfshatarëve, e ka varrosur Zekën në varrezat e fshatit.

**Burimet:** deklarata M.B, FDH-15573; deklarata Z.N, FDH-12427.

### Shaqë (Rrustem) Zeqiri

(1966, shqiptar nga Bokshiqi/Bokšić, komuna e Klinës/Klina, bujk)

Shaqë me prindërit e vet jetonin në Bokshiq/Bokšić. Ai nuk deshi të largohej nga shtëpia, kur familjarët e tij e braktisën fshatin dhe u strehuan në pyll, dhjetë ditë përpara sulmit të forcave serbe ndaj Bokshiqit/Bokšić. Në ditët në vijim, Shaqë shkonte kohë pas kohe në pyll për t'i vizituar prindërit. Në datën **22.05.1998**, kur forcat serbe depërtuan në fshat nga drejtimi i Grabanicës/Grabanica, Shaqë rastisi të ishte në shtëpi. Disa burra e braktisën menjëherë fshatin, por aji ndenji. Po atë ditë, familjari i Shaqës, Halili, e ka gjetur trupin e tij të pajetë në oborr [Bokshiq/Bokšić]. Në trupin e Shaqës ishin zbrazur afro 30 plumba. Me ndihmën e komshinjeve, Halili e ka varrosur trupin e Shaqës në bjeshkën përmbi fshatin e Bokshiqit/Bokšić. Në muajin qershor të vitit 1999, mbetjet e tij mortore u rivarrosën në varrezat e fshatit.

**Burimi:** deklarata Sh.Z, FDH-15574.

### Qaush (Haxhi) Fazlija

(25.10.1961, shqiptar nga Bokshiqi/Bokšić, komuna e Klinës/Klina, katër fëmijë, pjesëtar i UÇK-së)

Qaushi e ka mbaruar shkollën e mesme në Klinë/Klina. Aderoi në UÇK më 24.04.1998, kur në Bokshiq/Bokšić u themelua shtabi lokal i ushtrisë. Ka rënë në betejë me forcat serbe, e cila u zhvillua në **Bokshiq/Bokšić** më **22.05.1998**. Pjesëtarë të UÇK-së e kanë varrosur Qaushin në varrezat e fshatit më 30.05.1998.

**Burimet:** J. Martinsen, *Regjistri...*, FDH-260-

92; H. Hasani, *Dëshmorët...*, FDH-25596; FDH, *Që njerëzit ti mbajnë në mend njerëz*, pyetësor, FDH-31239.

### Brahim (Ahmet) Ukaj

(17.05.1933, shqiptar nga Zajmova/Zajmovo, komuna e Klinës/Klina, bujk, tetë fëmijë)

### Bajram (Demë) Kastrati

(1.05.1944, shqiptar nga Zajmova/Zajmovo, komuna e Klinës/Klina, murator, nëntë fëmijë)

Herët në mëngjes të datës **22.05.1998**, ka filluar bombardimi i fshatit Zajmovë/Zajmovo. Brahim dhe Bajrami u nisën me familjet dhe bashkëfshatarë të tjerë drejt pjesës së tjetër të fshatit, ku ishte më sigurt. Kur arritën te një gyp i ujit, Brahim dhe Bajrami e ndërjuan mendjen dhe vendosën të ktheheshin. U thanë familjarëve se nuk duan t'i braktisin shtëpitë e veta [**Zajmovë/Zajmovo**]. Ishte kjo hera e fundit që familjarët i shihnin të gjallë. Në mbrëmje, kur disa banorë u kthyen në pjesën e sulmuar të fshatit, i gjetën trupat e pajetë dhe të djegur të Brahimit dhe Bajramit në shtëpinë e vëllait të Brahimit. Në të njëjtën mbrëmje, që të dy u varrosën nga ana e komshinjeve në oborrin e Ukës. Tri ditë më vonë dhe me lejen e policisë, Uka me disa bashkëfshatarë i rivarrosën trupat e Brahimit dhe të Bajramit në varrezat në Zajmovë/Zajmovo.

**Burimet:** deklarata M.K, FDH-20214; deklarata Q.B, FDH-15582; KMDLNJ, *Buletini*, num. 7, prill-qershor 1998, 166, FDH-23816.

### Arif (Ramë) Berisha

(28.04.1968, shqiptar nga Qeskova/Českovo, komuna e Klinës/Klina, bujk, katër fëmijë, pjesëtar i UÇK-së)

Arifi aderoi në UÇK më 28.02.1998. Në datën 24.05.1998, Arifi ka qenë në pozicionet e UÇK-së në **Qeskovë/Českovo**, kur forcat serbe e sulmuan fshatin. Një ditë më vonë, më **25.05.1998**, pjesëtarë të forcave serbe nisën me bombardimin e fshatit dhe pozicioneve të UÇK-së, ku gjendej Arifi. Njëra nga predhat e ka plagosur rëndë dhe ai, pas pak, ndërroi jetë nga plagët e rënda. Po atë ditë, bashkëlufëtaret e kanë varrosur në varrezat lokale. Pas pë-